



## **ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА KOMUNA E GRAÇANICËS**

### **SHPJEGIMI I PROPOZIMIT TË RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË ADMINISTRATËS KOMUNALE**

#### **1. Çështja kryesore e trajtuar**

Me Propozimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Administratës Komunale përcaktohet dhe rregullohet organizimi i brendshëm i administratës komunale brenda secilit Departament.

#### **2. Objektivat dhe lidhja e tyre me prioritetet e Komunës**

Qëllimi i hartimit të propozimit të Rregullores është harmonizimi me aktet e reja ligjore që lidhen me zyrtarët publikë. Konkretisht, Ligji nr. 06 / L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligji nr. 06 / L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Gjithashtu, me këtë propozim të Rregullores janë marrë parasysh rregullativat ligjore dhe nënligjore nga fushat tjera relevante.

#### **3. Opsioni i rekomanduar**

Opsioni i rekomanduar i propozimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Administratës Komunale do të kontribuojë në zbatimin e papenguar të Ligjeve të lartpërmendura dhe funksionimin e vazhdueshëm të administratës komunale.

#### **4. Arsyetimi i propozimit nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

Përmbushja e standardeve në këtë fushë rrjedh nga fakti se ky propozim i Rregullores si akt nënligjor rrjedh nga rregullativa ligjore e harmonizuar me legjislacionin e BE-së.

## **5. Elementet kryesore të legjislacionit ose politikës së propozuar**

Propozimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Administratës Komunale, pikat referuese dhe dokumenti bazë është Rregullorja e mëparshme për Organizimin e Brendshëm të Administratës Komunale, si dhe Ligjet e përmendura nga fusha e zyrarëve publik.

## **6. Vlerësimi i ndikimit financiar në opsionet e propozuara**

Ndikimi financiar i këtij Propozimit të Rregullores do të harmonizohet në bashkëpunim me Departamentin e Buxhetit dhe Financave, si dhe me ministrinë e linjës.

## **7. Konsultimet dhe komentet**

Gjatë hartimit të Propozimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Administratës Komunale u konsultuan të gjithë pjesëmarrësit relevantë të cilëve u referohet ky propozim. Gjithashtu, përveç konsultimeve publike, Propozimi i Rregullores do të publikohet edhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës. Në fund, do të mbahet takimi final konsultativ, pas të cilit ky Propozim i Rregullores do të gjendet në Kuvend para këshilltarëve.

### **Shënim:**

Të gjitha persona të interesuara rekomandimet, komentet dhe sugjerimet e tyre mund të dorëzojnë më së voni deri më 21.06.2019, Jellenës Trajković, zyrtares e personelit (e-meil: [jelena.trajkovic@rks-gov.net](mailto:jelena.trajkovic@rks-gov.net))

Jelena Trajković, zyrtare e personelit  
Komuna e Graçanicës  
Rr. Cara Lazara  
10500 Graçanicë